



Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborna komisija za žalbe i molbe

A nr. 154/2010

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (KZAP), në panelin e përbërë nga Muharrem Shala, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Imer Hoxha, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega ne Istog, paraqitur kundër subjekti politik, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të heqjes, dëmtimit, mbulimit te posterave, që është ne kundërshtim me nenin 31 dhe me nenin 33 pika a, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-73) si dhe me nenin 4 paragrafi 1 pika a, të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, në seancën e panelit të mbajtur me 19.04.2010, mori këtë:

V E N D I M

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

A R S Y E T I M I

Subjekti Politik AKR dega ne Istog ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se subjekti politik AAK ka shqyer posterin e kandidatit për kryetar të komunës së Istogut nga subjekti politik AKR dhe ka mbuluar posterin me atë të kundër kandidatit nga radhët e AAK-së.

F A K T E T

Më 15 Prill 2010, KZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik AKR dega ne Istog, parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik AAK, ka shqyer dhe e ka mbuluar posterin e kandidatit për kryetar të komunës së Istogut nga subjektit politik AKR, me atë të kundër kandidatit nga radhët e AAK-së, në Rrugën “Lidhja e Prizrenit” afër klubit të futbollit në Istog, që është në kundërshtim më nenin 31 dhe me nenin 33 pika a, të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme të Republikës së Kosovës (Nr. 03/L-73) si dhe me nenin 4 paragrafi 1 pika a, të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009.

Parashtruesi i ankesës si provë ka sjell dy fotografi të bëra më datë 02.04.2010 në Rrugën “Lidhja e Prizrenit” afër klubit të futbollit në Istog.

ANALIZË

Juridiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

Rregullat dhe Procedurat e KZAP-it, neni 3 paragrafi 4, parasheh si vijon:

Përveç nëse nuk është saktësuar ndonjë afat tjetër, ankesa duhet të dorëzohet brenda tri ditëve pas ndodhjes së shkeljes së pretenduar apo brenda tri ditëve pasi që për shkeljen e pretenduar është njoftuar parashtruesi i ankesës ose nga dita kur ai është dashur të dijë për të.

KZAP-i konstaton se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 3 paragrafi 4 të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it, ngase në rastin konkret supozohet se shkelja ka ndodhur me 02.04.2010 ndërsa në Posten e Telekomit të Kosovës (PTK) është dorëzuar më 06.04.2010.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 154/2010 më datën 19.04.2010.

Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala

